

Thirrje për Aplikim Civil Society Scholar Awards (2019 -2020)

Programi i Bursave të **Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë**, shpall thirrjen për Aplikime për Bursat: **Civil Society Scholar Awards (CSSA)**, për vitin Akademik 2019 -2020.

QËLLIMI:

Civil Society Scholar Awards (CSSA) mbështet **projekte akademike ndërkombëtare** për të mundësuar studentët e doktoraturës dhe stafet akademike, të aksesojnë burime të rëndësishme për punën e tyre kërkimore, zhvillimin e tyre profesional si studiues, si intelektualë apo në mësimdhënie.

KUSH MUND TË APLIKOJË:

- **Studentë të Doktoraturës** që studiojnë në universitete të akredituara, brenda ose jashtë vendit;
- **Staf Akademik** me kohë të plotë në Universitetet në Shqipëri (kërkohej të kenë Diplomë Masteri).

AKTIVITET QË MUND TË FINANCOHEN:

Projekte ndërkombëtare akademike afatshkurtër, të tilla si: kërkim në terren (mbledhje të dhënash); vizita kërkimore në biblioteka, arkiva apo universitete; zhvillim kursesh/kurrikulash; dhe bashkëpunime kërkimore ndërkombëtare që çojnë në publikime 'peer- reviewed'.
Nuk ofrohet mbështetje për 'tuition fee'.

FUSHAT E STUDIMIT:

Propozimet për çdo fushë brenda **Shkencave Sociale dhe Humane** janë të mirëpritura, veçanërisht ato që lidhen me:

- Ligji, drejtësia, dhe qeverisja; Zhvillimi i qëndrueshëm dhe menaxhimin i burimeve natyrore; Të drejtat ekonomike dhe fuqizimin i të varfërve; Shëndeti publik, punë sociale dhe zhvillim komuniteti; Kuadri Ligjor dhe Politikat lidhur me 'New Media'; Arsimi gjithëpërfshirës; Studimet pas konfliktit; Të drejtat e njeriut.

AFATI I APLIKIMIT:

Afati i fundit për aplikim është **29 Mars 2019**

Mund të **aplikoni online** duke klikuar [ketu](#):

ose mund të dorëzoni aplikimin pranë zyrave të **Fondacionit** në Tiranë:

Rr. Qemal Stafa, P.120/2, Tiranë

Tel : +355 42234223

Më tepër informacion në lidhje me dokumentacionin e kërkuar do të gjeni te linku:

<https://www.opensocietyfoundations.org/grants/civil-society-scholar-awards>

Për çdo pyetje apo paqartësi ju mund të kontaktoni në adresën: bursa@osfa.al